

# S'KA VEND PËR VALLËZIM TË HOMOVE...

Prishtinë, 24 gusht

“Vetëm pse vallëzuan na larguan nga kafeteria “Ahër””, kanë bërë të ditur tre anëtarë të “Qendrës për Emancipim Shoqëror”, shoqata së cilës i takojnë ata. Një përfaqësues i lartë i kësaj shoqate për “Kosova Sot” tha se “dje në mbrëmje tre anëtarë të shoqatës sonë me orientim alternativ seksual kishin dalë për t’u shoqëruar dhe vallëzuar. Kësaj radhe ata kishin shkuar në kafeterinë

“Ahër”, ku kishte muzikë live. Derisa këta tre persona në fjalë vallëzonin, V. B., nga kompania e sigurimeve Black Panther, i ka kërcënuar se do t’i largojë nga ky lokal për shkak se disa të pranishëm përreth ishin ankuar se këta persona kërcenin me njëri-tjetrin dhe ky gjest i kishte shqetësuar ata. Në të njëjtën kohë, V. B. u ka thënë se gjeste të tilla të pahijshme nuk tolerohen në këtë lokal. Në atë moment, këta tre persona janë larguar nga lokali “Ahëri”, ka bërë të

ditur përfaqësuesi i kësaj shoqate. Ndër të tjera, ky i fundit ka thënë se Qendra për Emancipim Shoqëror do ta padisë në gjykatë V. B., kompaninë e sigurimeve Black Panther si dhe kafeterinë “Ahër”. Sipas tij, kërcënimet e tilla janë të patolerueshme për “Qendrën për Emancipim Shoqëror” dhe se janë në kundërshtim me Ligjin kundër diskriminimit, në bazë të Rregullores 2004/36, e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Luljeta HUMOLLI